

E ARDHMJA E ENERGJISË
ENERGJIA E RINOVUESHME
EFIÇENCA E ENERGJISË



ENERGY

EXPO & FORUM, TIRANA - ALBANIA
14 - 16 NËNTOR 2017

Nga:

Në bashkëpunim me:



BASHKIA
TIRANË

PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I SEKTORIT TË ENERGJISË

Shqipëria po zhvillon politika energjetike drejt një ekonomie me karbon të ulët dhe vazhdon të mbështesë e të promovojë gjenerimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

Nisur nga mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të instaluar si për prodhimin ashtu dhe për transmetimin e energjisë elektrike, Shqipëria është përballur me vështirësi në furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve. Mungesa e burimeve primare të energjisë, mungesa e burimeve dhe rrjeteve të gazit, kapacitete të limituara të prodhimit dhe të interkoneksionit, si dhe varësia e plotë e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet hidrike, janë disa nga vështirësitë, që kanë patur impaktin e tyre në mënyrë direkte dhe indirekte në jetën ekonomike dhe në cilësinë e kushteve të jetesës të vendit tonë.

Shqipëria është ndër vendet me potencial më të lartë për prodhimin e energjisë së rinovueshme në Europë. Qeveria Shqiptare, përmes një angazhimi të fortë politik dhe një strategjie kombëtare ambicioze ka pozicionuar sektorin e energjisë së rinovueshme si një ndër sektorët prioritarë. Vizioni afatgjatë i Qeverisë është pozicionimi i Shqipërisë si një nga ekonomitë kryesore të orientuara drejt energjisë së rinovueshme edhe si pjesë e politikës energjetike për të gjithë rajonin e Ballkanit. Rajoni ka një potencial të lartë për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

INICIATIVA QË PROPOZOHET

Për të adresuar të gjitha çështjet e problematikat që kanë të bëjnë me investimet në fushën e energjisë, Expcity Albania në bashkëpunim me MTE dhe Bashkinë e Tiranës, do të organizojë në dt. 14 -16 Nëntor një ekspozitë dhe forum mbi energjinë, të titulluar "Energy Expo & Forum 2017".

Misioni

Zhvillimi i sektorit energjetik, ai i burimeve të rinovueshme dhe rritjes së efikasitetit të energjisë në nivel Kombëtar dhe Rajonal dhe rritja e kontributit të këtij sektori në ekonominë e vendit.

Struktura

Energy Expo & Forum 2017 do të përbëhet nga:

- Zona e ekspozuesit: ku të gjithë aktorët e tregut të energjisë elektrike do të paraqesin produktet dhe shërbimet e tyre.
- Forumi Ekonomik: i cili do të trajtojë gjëndjen aktuale të tregut, legjislacionin e ri, mundësitë e financimit, mundësinë e investimeve në energjinë e rinovueshme, si dhe efikasitetin e energjisë.

KATEGORITË

PROFILI I SUBJEKTEVE PJESËMARRËSE

o Furnizues të teknologjisë së gjenerimit të energjisë

- Energjia fotovoltaike
- Energjia e erës
- Energjia e Ujit
- Energjia Gjeotermike
- Gazi



o Zgjidhjet e teknologjisë së ndriçimit me karakteristika të ruajtjes bazuar në energjinë diellore

- Teknologjia Led
- Zgjidhje të kombinuara



o Furnizues të teknologjisë së transmetimit të energjisë

- Transformatorët
- Linjat e energjisë
- Ndërprerjet dhe ingranazhet për shpërndarjen e energjisë



o Teknologjia e lidhur me energjinë hidrike

- Turbinat
- Sistemet e tubave



o Teknologjia e kursimit të energjisë

- Shoqëri në sektorin e efikasitetit të energjisë



1.53 GW

KAPACITETI I
INSTALUAR I
HIDROCENTRALEVE



o Bankat dhe institucionet financiare që mbështesin projektet e energjisë

- Bankat tregtare
- BERZH
- BSTDB
- BB-IFC
- Shoqëri sigurimi



o Shoqëritë e shërbimeve publike

- OSSHE
- KESH
- OST
- AKBN



344 ktoe/vit

PRODHIMI
NGA HIDROCENTRALET



o Projektet e mëdha të energjisë në vend

- Shoqëritë që kanë projekte të mëdha në Shqipëri

o Lojtarë të tjerë në fushën e energjisë

- Konçesione të reja
- Ofruesit e teknologjisë për energji smart ose projekte ekologjike me Bashkitë.



o Të tjerë:

- Përfaqësues të qeverisë shqiptare dhe Investitorët
- Shoqëri projektuese për studimet e fizibilitetit dhe ndikimin në mjedis.
- Përfaqësues të bashkisë së Tiranës
- CEO, Director, MD, GM, CFO të shoqërive të infrastrukturës dhe energjisë
- Këshilltarë të energjisë dhe të infrastrukturës
- Zyrtarë e avokatishë që operojnë në fushën e energjisë dhe të infrastrukturës
- Ekonomistë në fushën e energjisë e shumë të tjerë.

TEMAT KRYESORE QË DO TË TRAJTOHEN NË FORUM



► **Politikat energjetike**

1. Prezantimi hyrës mbi Shqipërinë, gjendjen energjetike dhe problematikat.
2. Prezantim mbi politikat, planet kombëtare, ligjet, aktet nënligjore të pritshme.
3. Prezantim mbi politikat dhe eksperiencat pozitive dhe negative në rajon, Evropë dhe botë.

► **Teknikat e gjenerimit të energjisë nga burime të rinovueshme**

1. Prezantim mbi përshtatshmërinë me rrjetin, përshtatja dhe investimet e nevojshme në rrjet për kurbën e prodhimit të teknologjive të rinovueshme.
2. Prezantim specifik mbi teknologjinë Fotovoltaikë.
3. Prezantim specifik mbi energjinë Eolike.
4. Prezantim specifik mbi energjinë nga biomasa (djegia, biogazi etj).
5. Prezantim mbi Skemën e matjes Neto të Energjisë për Vetëprodhuesit (Net Metering).
6. Panel diskutimi, pyetje përgjigje.

► **Qeverisja vendore si promotor i Energjisë së Rinovueshme dhe Efiçencës së Energjisë**

1. Efiçenca e energjisë për konsumatorët, procedurat dhe politikat që mund të ndiqen nga individët për të përmirësuar mënyrën e përdorimit të energjisë. (Erindi Bejko).
2. Bashkia si subjekt aktiv në përdorimin me efiçencë të energjisë.
3. Ndryçimi i qytetit (Bashkia synon të bëjë një studim tërësor të nevojave për ndryçim të qytetit të Tiranës, e më pas të hapë një garë për të përzgjedhur kompaninë me produktin më të përshtatshëm për qytetin).



Çdo pjesëmarrës mund të aplikojë online duke skanuar QR Code më sipër.

Për më shumë informacion kontaktoni:
Project Manager
Elisabeta GJEBREA
C: +355 66 4000 445
T: +355 42 387 083
M: elisabeta.gjebrea@expocity.al



Expo City Albania është një strukturë ndërkombëtare për organizimin e panairove dhe konferencave.

Shoqëria organizon dhe zhvillon panairove të ndryshme, ekspozita, organizime dhe evente të veçanta në rang vendor dhe ndërkombëtar. Qendra e panairove – me 5000 m² hapësirë të brendshme e 7000 m² hapësirë të jashtme ekspozuese dhe 800 vende parkimi – është objekti më i madh i këtij lloji në Tiranë.

Ndodhet afër qendrës së kryeqytetit dhe aeroportit ndërkombëtar dhe ka një pozitë të shkëlqyer strategjike për rajonin, afër rrjetit të transportit ndërkombëtar midis Lindjes dhe Perëndimit.

Expo City Albania iu ofron pjesëmarrësve në panairove dhe konferenca platformën më të mirë të mundshme për një komunikim sa më të suksesshëm në rajon.

Eksperiencia jonë e ndërthurur vendase dhe ndërkombëtare, stafi i kualifikuar dhe vizioni afatgjatë – do të garantojnë shërbimin dhe bashkëpunimin me të mirë për të përmbushur qëllimet e biznesit tuaj.